

Kapitulli i fundit

Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë

Për herë të parë, Banka e Shqipërisë, përpunoi dhe bëri publike, në formën e një dokumenti të quajtur “Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm”²⁵, objektivat dhe synimet e saj për një periudhë kohore të caktuar. Ai vendos në një rradhë të mirëzgjedhur etapat nëpër të cilat duhet ecur; problemet me të cilat do të ballafaqohet lëvizja drejt modelit të zgjedhur dhe, mbi të gjitha, burimet tek të cilat do të mbështetet institucioni, që janë njerëzit me aftësitë dhe dëshirën e mirë për të punuar.

Dokumenti i strategjisë u përgatit me qëllim që:

- * Të vlerësohet niveli i arritur në zhvillimin e institucionit.
- * Të përcaktohen objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm për zhvillimin institucional të Bankës së Shqipërisë.
- * Të përcaktohen afatet kohore për realizimin e objektivave.
- * Të përcaktohen prioritetet në zhvillimin e Bankës së Shqipërisë si institucion.

Hartimi i këtij dokumenti mendohet se i shërben:

- * Rritjes së transparencës së Bankës së Shqipërisë në bërjen publike të objektivave të saj.
- * Shmangies së zhvillimeve rastësore të institucionit dhe bashkërendimit të punës së njëjësive përbërëse të Bankës së Shqipërisë.
- * Përcaktimit të rrugëve konkrete që do të ndihmojnë për arritjen e objektivave strategjike.

Objektivat e përgjithshëm strategjikë të Bankës së Shqipërisë kanë të bëjnë me gjithë aktivitetin e saj.

- * Së pari, dokumenti përcakton modelin institucional për t’u mbajtur në konsideratë nga Banka e Shqipërisë që është **Banka Qendrore Europiane**.
- * Së dyti, Banka e Shqipërisë shpreh angazhimin për **rritjen e pavarësisë ligjore dhe reale** të saj, si banka qendrore e shtetit shqiptar, për t’i shërbyer sa më mirë detyrave të përcaktuara në ligj.

²⁵ Dokumenti “Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm” është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 111, datë 17.11.1999.

- * Së treti, Banka e Shqipërisë, gjithashtu, angazhohet për të **rritur përgjegjshmërinë e veprimeve dhe të vendimeve** të saj. Për këtë ajo është angazhuar në rritjen e transparencës me publikun dhe “edukimin” e tij me probleme të natyrës ekonomike e financiare.
- * Së katërti, Banka e Shqipërisë kërkon të veprojë në një mjedis të qëndrueshëm ligjor gjë që synohet të arrihet nëpërmjet **plotësimit dhe përmirësimit të paketës ligjore e rregullatore në fushën financiare.**
- * **“Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve”** është objektivi më i rëndësishëm strategjik i Bankës së Shqipërisë. Ky objektivi është materializuar në angazhimin për të mbajtur një normë vjetore inflacioni në nivelet 2-3 për qind. Politika monetare dhe ajo valutore do të harmonizohen dhe orientohen kah arritjes së këtij objektivi.
- * **Përmirësimi i statistikave** është një objektivi tjetër prioritar për Bankën e Shqipërisë. Në kushtet kur niveli i zhvillimit të statistikave në Shqipëri nuk është i kënaqshëm, Banka e Shqipërisë e pa të nevojshëm angazhimin në këtë proces dhe iniciimin e dy projekteve për zhvillimin e statistikave me synim anëtarësimin në GDDS dhe SDDS.
- * **Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të pagesave** me synim rritjen e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar. Për këtë objektivi do të punohet në dy drejtime: në përmirësimin e sistemit të pagesave ndërbankare dhe të sistemit të pagesave me vlera të vogla.
- * Së fundi, është përcaktuar që realizimi i objektivave strategjike do të arrihet nëpërmjet **kualifikimit të kapitalit human të Bankës së Shqipërisë dhe zhvillimit të teknologjisë së informacionit.**